REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS**
**DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INFRASTRUKTURËS PUBLIKE**
**SEKTORI I PROJEKTEVE PUBLIKE**

# RELACION TEKNIK

OBJEKTI:

"Ndërtim godine për zyra për MZSH”

Lgj. Nr. 1, Sheshi “Liria”, tel& fax +355 52 2/223 10 ëëë.durres.gov.al/, e-mail:info@durres.gov.al

## PËRSHKRIM I GJËNDJES EKZISTUESE

### 1. Të Përgjithshme

Projekti ka për objekt ndërtimin e një godine të re njëkatëshe, me sipërfaqe ndërtimi prej 206 m², e cila do të shërbejë për akomodimin e funksioneve administrative dhe operative të Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit të Bashkisë Durrës. Investimi synon përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e kapaciteteve funksionale të institucionit dhe krijimin e ambienteve të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë së përditshme, në përputhje me standardet teknike dhe kërkesat bashkëkohore të projektimit.
Godina e re është planifikuar të ndërtohet brenda territorit funksional të stacionit ekzistues të MZSH-së, në pjesën e pasme të objektit aktual, duke siguruar integrim funksional dhe arkitektonik me kompleksin ekzistues.

### 2. Vendndodhja

Objekti do të vendoset në një sipërfaqe brenda territorit të stacionit ekzistues të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, në një pozicion që mundëson lidhje funksionale me godinën aktuale dhe organizim efikas të aktivitetit të institucionit.
Zgjidhja e propozuar duhet të respektojë organizimin urbanistik dhe funksional të kompleksit ekzistues, duke garantuar funksionimin normal të shërbimit gjatë dhe pas realizimit të investimit. Vendosja e godinës nuk duhet të cenojë qarkullimin e automjeteve zjarrfikëse, manovrimin e mjeteve të emergjencës, aksesin në objektet ekzistuese, si edhe përdorimin e hapësirave operative të stacionit.



**Foto të gjendjes ekzistuese**





## 3. Koncepti Arkitektonik

Koncepti arkitektonik i objektit bazohet në krijimin e një godine njëkatëshe me karakter institucional, të projektuar sipas parimeve të funksionalitetit, racionalitetit dhe efikasitetit në përdorim. Zgjidhja arkitektonike synon të krijojë ambiente pune të përshtatshme për veprimtarinë administrative dhe operative të Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, duke garantuar fleksibilitet në organizimin e hapësirave, komoditet për përdoruesit dhe kosto të ulëta mirëmbajtjeje gjatë gjithë ciklit të jetës së objektit.

Arkitektura e godinës do të harmonizohet me kompleksin ekzistues të stacionit të MZSH-së, duke respektuar karakterin institucional të tij dhe duke siguruar një integrim të natyrshëm në kontekstin urban dhe funksional.

## 4. Organizimi Funksional

Godina do të organizohet në ambiente administrative, zyra pune, ambiente mbështetëse dhe hapësira ndihmëse, të projektuara për t'iu përgjigjur nevojave funksionale të personelit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

Shpërndarja e ambienteve do të mundësojë komunikim të shpejtë dhe efikas ndërmjet tyre, qarkullim të lirë të personelit, si dhe kushte optimale ndriçimi dhe ventilimi natyral, duke garantuar standarde të larta funksionale dhe komoditeti në përdorim.

5. Zgjidhja Konstruktive

Objekti do të projektohet me strukturë mbajtëse betonarme, në përputhje me Eurokodet dhe standardet teknike në fuqi. Elementët sekondarë të konstruksionit dhe mbulesës do të realizohen me profile metalike sipas projektit konstruktiv.

Mbulesa e godinës do të realizohet me panele sanduiç termoizoluese, të mbështetura mbi trarë metalikë tip IPE 200 ose ekuivalentë, duke garantuar qëndrueshmëri konstruktive, izolim termik dhe mbrojtje nga faktorët atmosferikë.

## 6. Materialet dhe Përfundimet

Materialet e ndërtimit dhe përfundimet arkitektonike do të zgjidhen në mënyrë që të sigurojnë jetëgjatësi, qëndrueshmëri dhe mirëmbajtje minimale. Në mbulesë parashikohet vendosja e izolimit termik me lesh xhami, si dhe realizimi i tavanit të varur me pllaka gipsi.

Dyshemetë do të realizohen me shtresa mbushëse mbi bazë çakëlli dhe soletë betoni, të përfunduara me pllaka qeramike me rezistencë të lartë ndaj konsumit. Fasadat do të trajtohen me materiale cilësore dhe rezistente ndaj lagështisë, rrezatimit diellor, kripëzimit dhe kushteve atmosferike karakteristike të klimës bregdetare të qytetit të Durrësit.

## 7. Infrastrukturat Inxhinierike

Objekti do të pajiset me të gjitha instalimet dhe rrjetet e nevojshme inxhinierike, duke u lidhur me

infrastrukturën ekzistuese të kompleksit të MZSH-së. Projekti do të përfshijë rrjetet e furnizimit me ujë, kanalizimet e ujërave të ndotura dhe atmosferike, instalimet elektrike, ndriçimin e brendshëm dhe të jashtëm, rrjetin e telekomunikacionit, si dhe sistemet e tjera ndihmëse të nevojshme për funksionimin normal të objektit.

**8. Siguria dhe Aksesueshmëria**

Projektimi do të realizohet në përputhje me legjislacionin dhe normat teknike në fuqi, duke garantuar sigurinë strukturore dhe funksionale të objektit. Do të parashikohen masat e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri, evakuimin në raste emergjence, sinjalistikën e sigurisë dhe aksesin e personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me kërkesat e projektimit universal.

**9. Përfundime**

Realizimi i godinës së re administrative me sipërfaqe ndërtimi 206 m² do të kontribuojë në përmirësimin e ndjeshëm të kushteve të punës së personelit të Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit të Bashkisë Durrës, duke rritur kapacitetet administrative dhe operative të institucionit. Investimi do të krijojë një infrastrukturë moderne, funksionale dhe të qëndrueshme, e cila do të mbështesë ofrimin e një shërbimi më efikas dhe më cilësor në përgjigje të situatave emergjente

**Planvendosja e struktures**



**Planimetria e Godines**




**Drejtoria e Projekteve , Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik:**
**Drejtor:** Alda Zyferi

**Përgjegjës Sektori i Projekteve Publike**: Bianka Madhi

**Punoi:** Ing. Eni Turkeshi
Ark. Nevian Mançe
Ing.elek.Mariglen Jahollari